



Kibla e xhamive të hershme: Jerusalemi apo Meka?

Description

Kibla e xhamive të hershme: Jerusalemi apo Meka?

M S M Saifullah, Muhammad Ghoniem, cAbd al-Rahmân Robert Squires, Mansûr Ahmed & Jason Hannan

Hyrje

Në këtë artikull do të diskutojmë një teori në lidhje me Kiblën muslimane, apo drejtimin e faljes, xhamitë e para në periudhën më të hershme të historisë islame. Një grup i vogël orientalistësh kanë argumentuar që xhamitë e hershme nuk ishin ndërtuar në drejtim të Mekës, por diku drejt Arabisë veriore apo drejt Jeruzalemit, teori kjo që vë në dyshim besimin musliman që xhamitë më të hershme kanë pasë qenë ndërtuar në drejtim të Mekës. Nocioni që xhamitë e hershme e kishin drejtimin nga Arabia veriore apo Jeruzalemi, nënkuptojnë në mënyrë të mbrapshtë mundësinë që muslimanët më të hershëm nuk janë lutur në drejtim të Mekës dhe që tradita islame e një Kible me drejtim nga Qabja ishte një ngjarje e vonshme, e fshehur nga historia me anë të një komploti. Përpjekjet që qendrojnë pas një teorie të tillë janë mjaft të dukshme po të kemi parasysh që ajo është propaganduar kryesisht nga orientalistë polemistë të tillë si Patricia Crone dhe Michael Cook. Dhe kjo teori është përsëritur si nga apologjetë të krishterë si Joseph Smith.

Thelbi i argumentit të Crone dhe Cook qëndron në sa më poshtë:

“Por rëndësia e veri-perëndimtarë targumik në gjeografinë e shenjtë të hagarenëve theksohet në mënyrë të veçantë nga të dhënat që kemi mbi historinë e hershme të Kiblës: kahja e lutjes duket se ka qenë diku drejt veri-perëndimit të Arabisë. Së pari kemi dëshmitë arkeologjike të dy xhamive emevite në Irak, ajo e Haxhaxhit në Uâsit dhe një tjetër, ndërtimi i së cilës i atribuohet së njëjtës periudhë dhe që ndodhet në periferi të Bagdadit. Këto xhami janë të drejtuara shumë në veri, respektivisht me 33 dhe 30 gradë; këto fakte mund t'i krahasojmë me faktet letrare që vërtetojnë që kibla e irakenëve ishte drejt perëndimit. Së dyti, kemi faktet letrare që kanë të bëjnë me Egjiptin. Nga ana islame ka një traditë sipas së cilës xhamia e Amr b. al-cÂs në Fustât ishte e drejtuar shumë drejt veriut dhe u desh që t'indërrohej drejtimi gjatë sundimit të Kurra b. Sharîk”.[1]

Çështja e Kiblës është përdorur nga këta autorë për të mbështetur hipotezën e tyre, sipas së cilës Islami është zhvilluar gjatë një periudhë kohe duke asimiluar fe të ndryshme në gjysmëhënën pjellore. Smith, i cili, në thelb nuk bën gjë tjetër veçse përsërit linjën e arsyetimit të Crone dhe Cook, thotë që:

“Sipas kërkimeve arkeologjike në xhamitë e lashta në Lindjen e Mesme, të kryera nga Creswell dhe Fehervari, dy plane të dy xhamive emevite në Irak, njëra e ndërtuar nga sundimtari Haxhaxh në Wasit (që Creswell e ka quajtur “xhamia më e vjetër në Islam që ka mbërritur deri në ditët tona” – Creswell 1989:41), dhe tjetra i është atribuar të njëjtës periudhë dhe ndodhet në afërsi të Bagdadit, shohim që Kibla (drejtimi në të cilin janë ndërtuar këto xhami) nuk gjendet përballë Mekës, por janë të drejtuara shumë në veri (Creswell 1969:137ff & 1989:40; Fehervari 1961:89; Crone-Cook 1977:23,173). Drejtimi i xhamisë në Wasit është i devijuar me 33 gradë dhe xhamia e Bagdadit me 30 gradë..”

Ne do të bëjmë një analizë metodike të këtij pretendimi, duke përdorur mjete moderne, të tilla si llogaritjet astronomike, për të llogaritur drejtimin e Kiblës së vërtetë dhe të Jeruzalemit nga vendndodhje të ndryshme. Më pas do të diskutojmë mbi mënyrën e përcaktimit të Kiblës në periudha të hershme islame, bazuar në traditën muslimane.

2. Shembull: Orientimi i xhamive të hershme në Uâsit, Bagdad, Kufa dhe Fustât (Kajro)

Fillojmë së pari me xhamitë që ndodhen në Uâsit, Bagdad, Kufa dhe Fustât. Më poshtë janë paraqitur drejtimet që janë llogaritur bazuar mbi formulat standarde që përdoren në astronomi për drejtimin drejt Mekës (Kibla) dhe Jeruzalemit për Uâsit-in, Baghdadin dhe Kufën.[2] Përcaktimi kompjuterik i Kiblës është bërë me anë të programit Minaret 1.4 dhe është verifikuar me anë të programit MacQiblah 2.1. Përveç kësaj, ne kemi zhvilluar një program për të rivërtetuar Kiblën e llogaritur me anë të dy programeve të mësipërme, si dhe për të përcaktuar drejtimin e Jeruzalemit nga vendi i përmendur. Vizatimet janë paraqitur me shkallë zvogëlimi.

Picture1

Image not found or type unknown

Figura 1: Drejtimi i Kiblës dhe Jeruzalemit nga Uâsit. Shigjeta blu tregon drejtimin e xhamisë së

hershme.

Xhamia më e hershme e ndërtuar në Uâsit ishte e shmangur me 33° nga Kibla e vërtetë. Kjo do të thotë që drejtimi i xhamisë ishte 122° në veriperëndim, rreth 31° nga Jeruzalemi, dhe jo por shumë më thellë në veri, në fakt më afër Jeruzalemit, siç pretendon Smith.

Kibla dhe drejtimi i Jeruzalemit nga Bagdadi është ilustruar më poshtë.

[Picture2](#)

Image not found or type unknown

Figure 2: Drejtimi i Kiblës dhe Jeruzalemit nga Bagdadi. Shigjeta blu tregon drejtimin e xhamisë së hershme.

Xhamia më e hershme në Bagdad është e shmangur me 30°. Domethënë, drejtimi i kësaj xhamie ishte 130° në veriperëndim, pothuajse 32° larg nga Jeruzalemi. Dhe majde nuk është e drejtuar as në afërsi të Jeruzalemit!

Në lidhje me shmangien e xhamive në Bagdad dhe Uâsit, Crone thotë:

“Fakti që kahja e të dy xhamive emevite të Irakut është shumë e shmangur në drejtim të veriut me 30 gradë (në fakt 30 dhe 33) të bën të mendosh që emevite e kishin fort për zemër saktësinë”. [3]

E kishin për zemër saktësinë? Në këtë rast do bënim mirë të analizojmë qëllimin e kësaj “saktësie” dhe të kuptojmë se çfarë ishte saktësisht “e orientuar shumë nga veriu”. Crone vetëm pretendon që Kibla ishte e “orientuar shumë në veri” për xhamitë e hershme të Bagdadit dhe Uâsitit dhe se emevitët “e kishin fort për zemër saktësinë” pa marrë mundimin që t’i shpjegojë lexuesve drejtimin e saktë të Kiblës. Të bezdis mania dashakeqe e gjymtimit të informacionit, taktikë kjo e përdorur aq shpesh nga Crone në shkrimet e saj (dhe me një bindje përrulëse, edhe nga Smith në shkrimet e tij) në një përpjekje të dëshpëruar për të treguar që vendi i shenjtë i muslimanëve të hershëm gjendej diku në Arabinë veriore apo Jeruzalem. [4,5] Nëse do të verifikonim argumentin e Crone thjesht duke i hedhur një sy hartës, do ta kishim të qartë që kahjet e paraqitura as që janë të orientuara drejt Arabisë veriore apo Jeruzalemit.

Picture3

Image not found or type unknown

Figure 3: Drejtimi i Kiblës dhe Jeruzalemit nga Kufa. Shigjeta blu tregon orientimin e xhamive të hershme.

Në lidhje me xhaminë në Kufa, Smith thotë:

“Kjo përputhet me bindjen e Baladhuri-t (të quajtur Futuh) sipas të cilit Kibla e xhamisë së parë në Kufa, Irak, që mendohet të jetë ndërtuar në vitin 670 e.s. (Creswell 1989:41), gjendej gjithashtu në perëndim, ndërkohë që duhet të ishte në drejtim të jugut (Futuh i el-Baladhuri-t, ed. by de Goeje 1866:276; Crone 1980:12; Crone-Cook 1977:23,173)”.

Siç mund të shihet në figurë [6], orientimi i xhamive në Uâsit dhe Baghdad nuk përputhet me “dëshminë” e Baladhuri-t; ajo vetëm se tregon që Kibla është lehtësisht e shmangur në drejtim të perëndimit; më saktë $145^{\circ} 42'$ në veriperëndim. Në fakt, orientimi i xhamive më të hershme të Uâsitit, Baghdadit dhe Kufës janë më afër Mekës, duke hedhur poshtë në këtë mënyrë pretendimin e Smith, sipas të cilit ato e kishin drejtimin “më afër Jeruzalemit”.

Më tej Smith shton:

“Plani origjinal i xhamisë së Amr b. al As, që ndodhet në Fustat, qyteti fortesë në periferi të Kajros, Egjipt, tregon që Kibla ishte e drejtuar thellë në veri dhe është korigjuar më vonë në periudhën e sundimit të Kurra b. Sharik (Creswell 1969:37,150). Është interesante se ky fakt përputhet me traditën e mëvonshme islamike, të hartuar nga Ahmad b. al-Maqrizi, që Amr lutej me fytyrë nga juglindja dhe jo në drejtim të jugut (al-Maqrizi 1326:6; Crone-Cook 1977:24,173)”.

Ky është një rast interesant. Figura e paraqitur më poshtë tregon drejtimin e Kiblës dhe Jeruzalemit nga Kajro (shumë afër Fustâtit).

Picture4

Image not found or type unknown

Figure 4: Drejtimi i Kiblës dhe Jeruzalemit nga Kajro. Shigjeta blu tregon drejtimin e xhamisë së

hershme.

Xhamia e Amr bin al-Âs në Fustât në rrethinat e Kajros është e orientuar me 27° në juglindje (ose 117° në verilindje) si tregohet me shigjetën blu.[7] Kjo xhami, për të cilën Smith thotë se është e drejtuar lehtësisht nga juglindja, në të vërtetë është e orientuar në drejtim të Mekës dhe jo Jeruzalemit dhe është pothuajse 57° e shmangur nga Jeruzalemi!

Smith pretendon gjithashtu:

“Nëse do të përdornit një hartë, do ta gjenit drejtimin e këtyre xhamive. Të katër shembujt e mësipërm e paraqesin pozicionin e Kiblës jo në drejtim të Mekës, por shumë më thellë në veri, në fakt më afër periferisë së Jeruzalemit”.

Mbase, do të ishte mire që vetë Smith të merrte mundimin të përdorte një hartë dhe të zbulonte se nga e kishin në të vërtetë drejtimin këto xhami. Asnjëra nga të katër xhamitë që ai përmend nuk ishte e orientuar “në afërsi” të periferisë së Jeruzalemit, e jo më në drejtim të ndonjë vendi të shenjtë misterioz në Arabinë veriore.

Studimet e kohëve të fundit tregojnë që në xhamitë e hershme, për përcaktimin e Kiblës janë përdorur metoda astronomike. Një dukuri astronomike si lindja apo perëndimi i diellit gjatë ekuinokseve dhe solsticeve, Ylli Polar, Kanopus, etj, janë përdorur për të përcaktuar orientimin e xhamive në drejtim të Kiblës. Përsa i përket xhamive të hershme në Egjipt dhe Irak, David King thotë:

“Xhamia e parë në Egjipt është ndërtuar në drejtim të lindjes së diellit në dimër dhe pikërisht ky mbeti orientimi më i përdorur nga autoritetet fetare gjatë gjithë periudhës mesjetare. Po kështu, disa nga xhamitë më të hershme në Irak janë ndërtuar në drejtim të perëndimit të diellit në dimër. Vetëm kohët e fundit është bërë i njohur fakti që për përcaktimin e Kiblës kanë pasë qenë përdorur metoda astronomike, kështu që disa historianë bashkëkohorë kanë nxjerrë përfundime të gabuara nga orientimet e xhamive të hershme në Egjipt dhe Irak, duke pohuar që këto nuk janë ndërtuar aspak me drejtim nga Qabja, por në drejtim të ndonjë tjetër vendi të shenjtë. Megjithatë, tani e dimë madje edhe përse janë përdorur metoda të tilla astronomike”.[8]

Kjo hedh përfundimisht poshtë qendimin e “historianëve bashkëkohorë” si Patricia Crone dhe Micheal Cook dhe misionari i krishterë Joseph Smith.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e lartpërmendura në lidhje me orientimin e xhamive të hershme dhe perëndimeve e lindjeve të diellit (d.m.th. në solsticin dimëror, më 2 dhjetor) me qëllim që t’ia lehtësojmë lexuesit kuptimin e tyre. Azimuthet janë llogaritur me anë të programit që përmendet në shtojcë, origjina e Kiblës, azimuthit dhe orientimit të xhamisë është paraqitur në verilindje.

[Screen Shot 2019-08-26 at 2.27.12 AM](#)

Image not found or type unknown

Table I: Orientimi i xhamive në drejtim të lindjeve dhe perëndimeve të diellit në dimër

Diferenca mes orientimit të xhamisë dhe azimutëve përkatëse të lindjes/perëndimit të diellit për qytetet është e vogël, me përjashtim të Kufës, ku drejtimi i xhamisë është më afër Kiblës së vërtetë.

Kjo tregon që xhamitë e hershme (përveç Kufës, sigurisht) ishin astronomikisht të orientuara në drejtim të lindjeve/perëndimeve përkatëse.

Po sikur këto xhami të ishin të orientuara në drejtim të perëndimeve/lindjeve të diellit në verë?

Screen Shot 2019-08-26 at 2.27.54 AM

Image not found or type unknown

Tabela II: Orientimi i xhamive në drejtim të lindjeve dhe perëndimeve të diellit në verë

Është interesante që nëse Kiblat e xhamive të lartpërmendura do të ishin të orientuara në drejtim të perëndimeve dhe lindjeve të diellit në verë atëherë të gjitha xhamitë e Irakut do të ishin të shmangura nga drejtimi i Kiblës së vërtetë me $>90^\circ$ (krahaso Tabelat I dhe II); Jeruzalemi do të ishte i shmangur me rreth 30° . Vetëm xhamia e Egjiptit do të ishte e orientuar në drejtim të Jeruzalemit (Tabela II).

Duke i hedhur një sy të shpejtë Figurave 1-3, mund të shihet që nëse muslimanët do të kishin zgjedhur perëndimin e diellit gjatë ekuinokseve për të përcaktuar drejtimin, Kiblat e xhamive në Irak do të ishin të orientuara në drejtim të Jeruzalemit. Kjo u është lënë lexuesve si “detyrë shtëpie” që ta verifikojnë vetë duke përdorur formulën në shtojcë. Pra, me pak fjalë, përcaktimi i orientimit të xhamive në Irak duke përdorur perëndimin e diellit në dimër do të ishte mënyra më e mirë për t’iu afruar Kiblës. Përcaktimi i orientimit po në këtë mënyrë të xhamisë së Egjiptit në drejtim të lindjes së diellit në dimër do të jepte një Kibël shumë afër me atë të llogaritur në mënyrë kompjuterike.

Por, përsëri mbetet një pikëpyetje. Përse muslimanët kanë zgjedhur për xhamitë në Irak perëndimin e diellit në dimër, ndërsa për xhaminë e Egjiptit lindjen e diellit në dimër për të përcaktuar Kiblat e tyre përkatëse? Cila është lidhja mes këtyre dukurive astronomike në lidhje me Qaben? Përgjigja e këtyre pyetjeve qëndron në orientimin astronomik të Qabes.

3. Drejtimi astronomik i Qabes

Kohët e fundit është mësuar që, për shekuj me radhë, muslimanët kanë përdorur gjerësisht metodat astronomike për llogaritjen Kiblës dhe për orientimin e xhamive në drejtim të Qabes. Kibla e disa xhamive të hershme dhe mesjetare është llogaritur të jetë “paralel” me një nga muret e Qabes dhe ky “paralelizëm” arrihej duke e ndërtuar xhaminë në drejtim të të njëjtit horizont astronomik sikur dikush të qendronte përballë murit të Qabes. Arsyeja e përdorimit të metodave astronomike, e veçanërisht drejtimeve kardinale dhe solsticiale dhe pika e ngritjes së yllit Canopus, tani mund të kuptohet nën dritën e përcaktimit astronomik të vetë Qabes. Përdorimi i metodave astronomike (dhe gjithashtu drejtimet që kanë të bëjnë me erërat, shih Fig. 11) për Kiblat është parapëlqyer në fakt nga autoritetet fetare më shumë se llogaritja matematike e drejtimeve të Kiblës nga astronomët muslimanë në periudhën mesjetare.[9]

Figurat 5 dhe 6 paraqesin pozicionin e Qabes, siç përshkruhet në MS Milan Biblioteca Ambrosiana 73 Sup., një traktat i një astronomi jemenas, Muhammad ibn Abî Bakr al-Fârisî (1290).[10]

Picture6

Image not found or type unknown

Figure 5: Koordinatat e Qabes që përmenden në kreun e parë të tekstit të ilustruara në MS Milan Biblioteca Ambrosiana 73 Sup.

Picture7

Image not found or type unknown

Figure 6: Koordinatat e Qabes, siç përshkruhen në pjesë e dytë të tekstit të ilustruar në MS Milan Biblioteca Ambrosiana 73 Sup.

Disa studime të kryera nga Hawkins dhe King, duke përdorur mjete astronomike, kanë treguar që vendndodhja e vërtetë e Qabes është si më poshtë:

Picture8

Image not found or type unknown

Figure 7: Vendndodhja e vërtetë e Qabes.

Picture8

Image not found or type unknown

Figure 8: Vendndodhja astronomike e Qabes, e paraqitur me shkallë zvogëlimi.[11]

Nga sa u tha më sipër kuptojmë përse xhamitë e hershme në Irak ishin ndërtuar në drejtim të perëndimit të diellit në dimër. Ndërtimi i xhamive të Irakut në këtë pozicion do të thotë se ato gjendeshin “përballë” murit verilindor (apo jugperëndimor) të Qabes (Figura 5 dhe 8). Po kështu, shohim që xhamia e Amr bin al-cÂs në Fustât pikërisht në rrethinat e Kajros gjendej në drejtim të lindjes së diellit dimëror dhe kjo do të thotë që ato ndodheshin “përballë” murit veriperëndimor (apo juglindor) të Qabes (Figura 6 dhe 8). Qëllimi i këtij orientimi astronomik nuk është kuptuar nga Crone dhe Cook dhe të tjerët dhe arsyeja e kasaj ka shumë të ngjarë të jetë mungesa e njohurive mbi astronominë në përgjithësi dhe atë islamike në veçanti. Ashtu si Crone dhe Cook, Suliman Bashear dhe Moshe Sharon kanë patur të njëjtën linjë argumentimi, duke përdorur burime të ngjashme islamike letrare në lidhje me Kiblën e xhamive të hershme në Fustât pa marë mundimin që të informojnë lexuesin se cili është drejtimi i saktë i Kiblës. Bashear thotë:

“... është me vend të sjellim edhe të dhënat që sjellin disa studiues në lidhje me lutjen e Amr bin al-cÂs në një kishë të Egjiptit, ku ai ka bërë vetëm një devijim të lehtë nga kibla e saj lindore, si dhe faktin që xhamia që mban emrin e tij kishte një kibël “shumë të kthyer në drejtim të lindjes” (qibla musharriqa jidan) dhe se ajo ka mbetur në këtë pozicion derisa sunduesi el-Walîd, Kurra b. Sharîk, në 92 h. e ktheu nga jugu në drejtim të Mekës”. [12]

Kibla e Kajros gjendet $46^{\circ} 20'$ në juglindje dhe jo në “jug në drejtim të Mekës”. Në burimet e cituara nga Crone dhe Cook [13] Bashear dhe Sharon [14] nuk përmendet shkalla e shmangies, por të gjithë këta kanë sugjeruar që Amr bin al-cÂs është lutur i kthyer lehtësisht drejt juglindjes apo lehtësisht i kthyer nga lindja. Kjo do të thotë që ai qenka kthyer tamam përballë lindjes së diellit dimëror, që përbën vetëm një shmangie e lehtë nga lindja; më saktë 27° në juglindje. Nën dritën e burimit të mësipërm të cituar nga Bashear pyesim veten se ç’arsye ka patur Kurra bin Sharîk të korrigojë Kiblën! Nuk jemi në dijeni të ndonjë burimi letrar ku thuhet se Kurra bin Sharîk ta ketë korrigjuar drejtimin e xhamisë në drejtim të Kiblës. Kjo për arsye se Amr bin al-cÂs edhe në ditët tona është ende e orientuar drejt lindjes së diellit dimëror.

Në fakt, Sharon pranon që xhamia e Amr bin al-cÂs është e orientuar drejt lindjes së diellit dimëror, por kjo bie në kundërshtim me tezën e tij që Kibla e xhamive të muslimanëve të hershëm në zonat e dominuara nga të krishterët, si Siria dhe Egjipti ishte Kibla e të krishterëve, në drejtim të lindjes! Na çudit saktësia e sensit të drejtimit që ka Sharon kur thotë që Kibla në Siri ishte e orientuar drejt lindjes.

Ai nuk përmend asnjë burim për ta mbështetur këtë pretendim. Ajo që është e qartë është se ai nuk i kupton detajet e astronomisë; dallimi mes lindjes së diellit dimëror dhe lindjes ekuinoksiale të diellit. Po kështu, ai nuk është i vetëdijshëm për ekzistencën e disa burimeve letrare të kohëve të fundit, në të cilat përmendet përdorimi i metodave astronomike për të përcaktuar orientimin si të xhamive të hershme, ashtu edhe të atyre mesjetare në drejtim të Kiblave të tyre.

Nga sa u diskutua më lart dalim në përfundimin që muslimanët e hershëm, megjithëse nuk e njihnin mirë astronominë, ka patur një ide qarta në lidhje me orientimin e lindjeve dhe perëndimeve të diellit, ngritjes së yllit Canopus në raport me Qaben në periudha të ndryshme të vitit. Këto dukuri astronomike janë përdorur për të orientuar xhamitë në drejtim të Kiblave të tyre përkatëse. David King thotë:

“Për shembull, sipas burimeve tona, Kibla në Afrikën Veriperëndimore gjendej në drejtim të lindjes së diellit në ekuinokse, në drejtim të lindjes; që kibla në Egjipt ndodhej në drejtim të lindjes së diellit në mesin e dimrit; që kibla në Jemen ndodhet në drejtimin nga fryn era veriore ose në drejtim të Yllit Polar, i cili nuk lind apo perëndon, por pozicioni i tij përcakton veriun; që Kibla në Siri ndodhet në drejtim të lindjes së Canopus; që Kibla në Irak ndodhet në drejtim të perëndimit të diellit në mesin e dimrit; dhe që kibla në Indi ndodhet në drejtim të perëndimit të diellit në ekuinokse, drejt lindjes”. [15]

Nga sa më sipër mund të thuhet që xhamitë, orientimi i të cilave është përcaktuar duke u bazuar në dukuritë astronomike, nuk janë orientuar gjithmonë në mënyrë të saktë në drejtim të Kiblës.

4. Çfarë thotë Jacobi i Edessës në lidhje me Kiblën e muslimanëve

Ajo që është e vështirë të besohet është fakti që Crone dhe Cook, e po ashtu edhe Smith citojnë Jacobin e Edessës për të mbështetur argumentin tyre, sipas të cilit Kibla e muslimanëve nuk ishte e fiksuar në drejtim të Mekës (apo Qabes) ndërkohë që Jacobi i Edessës në të vërtetë thotë:

“Hebrejtë që jetojnë në Egjipt, ashtu si edhe Mahgraye-t, siç e pashë me sytë e mi, luteshin në drejtim të lindjes dhe ende e bëjnë këtë, të dy popujt – hebrejtë në drejtim të Jeruzalemit dhe Mahgraye në drejtim të Qabes (Kcbt’). Dhe ata hebrej që janë në jug të Jeruzalemit luten në drejtim të veriut; dhe ata në Babiloni dhe nhr’ dhe bwst’ luten në drejtim të perëndimit. E gjithashtu edhe Mahgraye-t që janë atje luten në drejtim të perëndimit, drejt Qabes; dhe ata që janë në drejtim të jugut të Qabes luten nga veriu, në drejtim të vendit. Pra, nga e gjithë kjo, shihet qartë që hebrejtë dhe Mahgraye-t nuk luten në drejtim të jugut këtu në viset e Sirisë, por në drejtim të Jeruzalemit apo Qabes, vendet patriarkale të racave të tyre”. [16]

Kjo, në të vërtetë, vërteton të kundërtën e asaj që pretendojnë Crone dhe Cook, e po ashtu edhe Smith. Struktura e fjalisë tregon qartë që kanë ekzistuar dy vende të ndryshme: Jeruzalemi dhe Qabja (vini re gjithashtu edhe formën në shumës të fjalëve “vend” dhe “racë”). Çdo përpjekje për të pretenduar që ka patur më shumë se një Qabe është e destinuar të dështojë. Fjala Qabe në arabisht do të thotë “kub” dhe e vetmja Qabe është ajo që ndodhet në Mekë.

Në Egjipt, muslimanët luteshin në drejtim të “lindjes” (d.m.th. lindja e diellit dimëror) siç ka vëzhguar me saktësi Jacobi i Edessës (shih Figuren 4). Interesante është që Jacobi i Edessës vërteton vendndodhjen e Kiblës së muslimanëve duke thënë që ata janë lutur gjithmonë në drejtim të Qabes, kudo që të ndodheshin. Crone dhe Cook, e po ashtu edhe Smith e bazojnë hipotezën e tyre në diçka që mund të quhet fare mirë një sharlatanizëm i mirëfilltë.

5. Cili ishte drejtimi i xhamive të hershme në Negev?

Megë Crone dhe Cook kanë konkluduar nga Kibla e xhamive të hershme se ato ishin të orientuara në drejtim të një vendi të shenjtë misterioz në Arabinë veriore, do të donim të kujtonim që ata, qëllimisht e kanë lënë pa përmendur orientimin e njëres prej xhamive më të hershme: el-Masjid el-Aqsa. Kjo xhami është e orientuar drejt veriut, në drejtim të Mekës. Më tej do të donim të shtonim gjithashtu një studim të kohëve të fundit për të verifikuar pretendimet e Crone dhe Cook.

Kohët e fundit, Avni ka studiuar 12 xhami (10 të hapura dhe 2 të mbyllura) në vendbanimet e rrafshnaltës së Negev, Palestinën e Pushtuar dhe ka zbuluar se ato datojnë në dy shekujt e parë të hixhrit.[17] Ai jep gjithashtu të dhëna edhe për azimuthin e mihrâb-it (d.m.th. Kiblës) së xhamive të ndryshme.[18] Çuditërisht, nuk përmenden metodat astronomike për përcaktimin e Kiblës. Për shkak të afërsisë me njëra tjetrën të këtyre vendndodhjeve, do të marrim si pikë reference Kiblën e një vendi të quajtur Sede Boqer.[19] Të dhënat që jep Avni skematizohen në këtë mënyrë:

Picture10

Image not found or type unknown

Figure 9: Drejtimi i Kiblës nga Sede Boqer. Shigjetat me ngjyra tregojnë drejtimin e Kiblave në 12 xhami, sipas studimit të Avni. Vetë xhamia në Sede Boqer është e orientuar 166° në lindje të veriut, rreth 13° larg Kiblës së vërtetë. Ngritja e Canopus tregohet me një shigjetë blu në fund të figurës.

Siç mund të shihet, shmangia maksimale nga Kibla e vërtetë është rreth 29° për një xhami që e ka Kiblën e saj në drejtim të jugut. Pjesa tjetër janë të shmangura me 5 deri 19° nga Kibla e vërtetë. Tani çështja është: cila metodë është përdorur për përcaktimin e drejtimin të këtyre xhamive të hapura në rrafshnaltat e Negev-it që ka dhënë një shkallë kaq të madhe saktësie? Sigurisht jo lindja e diellit veror, dimëror apo ekuinoksi. Të ketë qenë vallë ngritja e njërit prej yjeve, psh. Canopus, një prej yjeve më të ndritshëm në hemisferën jugore? Për të vërtetuar dyshimet tona ne bëmë një simulim të qiellit të natës në Sede Boqer me anë të programit kompjuterik Starry Night Backyard 3.1. Rezultatet qenë befasuese.

Image not found or type unknown

Figure 10: Një imitim i Canopus duke u ngritur në Sede Boqer në një azimuth prej 158° . Canopus ngrihet në Sede Boqer në një azimuth prej 158° (verilindje). Kibla në Sede Boqer ndodhet $153^\circ 15'$ në verilindje. Diferenca është prej 5° ! Të 11 xhamitë janë të orientuara mes 158 deri 172° dhe vetëm njëra është pak e shmangur me rreth 182° (Figura 9). Përcaktimi i pozicionit të xhamive me anë të Canopus do të thoshte “përballë” murit veriperëndimor (apo juglindor) të Qabes (Figura 8). Megjithëse nuk disponojmë burime letrare islamike që vërtetojnë bindjen tonë, jemi shumë të sigurtë që Canopus është përdorur për të përcaktuar orientimin e këtyre xhamive të hapura në drejtim të Kiblës. Vlen të shtohet këtu fakti që asnjëra prej këtyre xhamive të hershme nuk është e orientuar në drejtim të Arabisë veriore apo Jeruzalemit.

Pasi diskutuam çështjet kryesore, do të përqendrohemi në gjetjen e Kiblës sipas traditës islamike. Kjo do të na ndihmojë që të kuptojmë disa nga çështjet që kanë të bëjnë me shmangien e Kiblës me disa gradë. Më pas do të diskutojmë mbi metodat e ndryshme të përcaktimit të Kiblës që janë përdorur nga muslimanët e hershëm para erës së llogaritjeve matematikore të Kiblave.

6. Kibla gjendet mes Lindjes dhe Perëndimit: Gjetja e Kiblës sipas traditës islame

Ekzistojnë shumë tradita në trashëgiminë islame që tregojnë se përcaktimi i Kiblës është bërë me fleksibilitet, përveçse për Mekën, falë njohurive të pakta në fushat e gjeografisë dhe gjeometrisë në shekujt e parë të Islamit. Këto tradita mund të gjenden në shumë përmbledhje hadithesh me emrin Sunan el-Tirmidhî, Sunan Ibn Mâjah dhe Muwatta’ Mâlik siç më poshtë.

a. Muwatta’ Mâlik

“Mâlik më ka treguar në autoritetin e Nâfi-ut që cUmar Ibn al-Khattâb ka thënë: “[Cilido drejtim] mes lindjes dhe perëndimit merret si Kibla, përsa kohë të jeni të drejtuar nga Shtëpia “.

Në Al-Muntaqâ – komentarin mbi Muwatta’, lexojmë sa më poshtë në lidhje me këtë hadith:

“Në lidhje me pohimin: “[Kudo] mes Lindjes dhe Perëndimit gjendet Kibla”, Ahmed Ibn Hanbeli ka thënë: “Kjo vlen për të gjitha vendet, përveçse për Mekën në Shtëpinë [d.m.th, Xhaminë e Shenjtë] ku, kushdo që devijon prej saj është larguar nga Kibla.” Ahmed Ibn Khâlîd ka thënë: “Ky hadith vlen për banorët e Medinës dhe për këdo, Kibla e të cilit është mes Lindjes dhe Perëndimit”, transmetuar nga Muhammad Ibn Maslamah, ky nga Mâlik. Ahmad Ibn Khâlîd ka thënë: “Përsa i përket atyre që

ndodhen në lindje apo perëndim të Mekës, Kibla e tyre ndodhet mes Jugut dhe Veriut dhe ata janë të lirë në këtë [d.m.th. fleksibilitet në përcaktimin e drejtimit] siç kanë qenë edhe banorët e Medinës dhe të tjerët.” Ky mendim i cituar nga Ahmad Ibn Khâlid është i qartë dhe i saktë, por kjo shoqërohet me përpjekje [ixhtihâd] për këdo që ka njohuri në këtë drejtim. Kjo i dedikohet faktit që në qendrimin e tyre përballë Kiblës, njerëzit ndahen në dy kategori. Së pari, ata që mund ta shohim Shtëpinë duhet të drejtohen drejt saj dhe nuk lehojët që të veprojnë ndryshe, sepse për ta është e detyrueshme për ata që e shohin Kiblën që ta ndjekin atë dhe kushdo që nuk e bën këtë, padyshim ka devijuar prej saj, gjë që është ndaluar dhe nuk ka asnjë dyshim në lidhje me këtë. Një mendim i ngjashëm është mbështetur nga Muhammad Ibn Maslamah.

Së dyti, ata që nuk mund ta shohin Kiblën janë ose njerëz të aftë që të kryejnë ixhtihad ose imitues. Ata që janë në gjendje të kryejnë ixhtihadin janë të detyruar ta bëjnë atë në mënyrë që të përcaktojnë drejtimin e Kiblës mes Lindjes dhe Perëndimit, duke u kthyer në drejtim të Shtëpisë. Por ata që nuk janë të prerë për ixhtihad duket të ndjekin këtë të fundit. Përndryshe, siç ka thënë Qâdî Abû al-Walîd, Allahu qoftë i kënaqur me të, ai konsiderohet si një njeri të cilit i janë fshehur faktet që tregojnë drejtimin e Kiblës. Unë do të parapëlqejë që ai të vonojë lutjet deri në fund të afatit të tyre kohor, me shpresë që të gjejnë dikë që ta imitojnë dhe kjo vlen për çdo vend me përjashtim të Medinës, ku nuk është e përshtatshme të bëhet ixhtihad që çon në një Kibël të ndryshme nga ajo e Xhamisë së Profetit, meqenëse është Profeti, paqja qoftë mbi të, ai që e ka caktuar Kiblën e saj dhe kjo përbën një fakt të pamohueshëm në lidhje me këtë çështje. Ibn al-Qâsim transmeton nga Mâlik që Xhibrili, paqja qoftë mbi të, i ka treguar Profetit drejtimin e Kiblës së xhamisë së tij”.

b. Sunan el-Tirmidhî

“Muhammad Ibn Abî Ma’shar na ka thënë: Babai na ka thënë në autoritetin e Muhammad Ibn cAmr nga Abû Salamah nga Abû Hurayrah që i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të, ka thënë: “[Kudo] mes Lindjes dhe Perëndimit ka një Kibël.” Kjo është transmetuar edhe prej Yahyâ Ibn Mûsâ, në autoritetin e Muhammad Ibn Abî Macshar. Abû cîsâ ka thënë: “Hadithi i Abû Hurejras është transmetuar në mënyra të tjera. Disa dijetarë kanë përmendur kujtesën e dobët të Abû Macshar, emri i tij është Nujayh, skllavi i liruar i Benû Hâshim.” Muhammad [el-Bukhârî] ka thënë: “Unë nuk transmetoj asgjë nga ai, ndërkohë që ka njerëz që kanë transmetuar prej tij”. Muhammad ka thënë: “Hadithi i cAbdullâh Ibn Jacfar el-Makhramî nga cUthmân Ibn Muhammad el-Akhnasî nga Sacîd al-Maqbarî nga Abû Hurayrah është më i mirë dhe më origjinal se hadithi i Abû Macshar”

Imâm al-Ahwadhî komenton në lidhje me hadithin e përmendur më lart në librin e tij Tuhfah:

“I Dërguari i Allahut, paqja e Zotit qoftë mbi të, ka thënë: Kudo mes Lindjes dhe Perëndimit gjendet Kibla”.

El-Suyûtî ka thënë: “Kjo nuk vlen për çdo vend, por vetëm për Medinën dhe rrethinat e saj.” El-Beiheki, në Al-Khilâfiyyât [Çështjet kontradiktore] ka thënë: “Ky hadith nënkupton, dhe Allahu e di më mirë, banorët e Medinës dhe ata, për të cilët Kibla është e njëjtë me atë të banorëve të Medinës.” El-Shawkânî ka thënë: “Ka patur mosmarrëveshje në lidhje me kuptimin e këtij hadithi.” El-clrâqî ka thënë: “Ky nuk është një përgjithësim për të gjitha vendet, por vetëm për Medinën dhe çdo vend që ka të njëjtën Kibël dhe ky është edhe mendimi i el-Beihekit në Al-Khilâfiyyât, si dhe ai i Ahmad Ibn Khâluweih al-Rahbî, i cili ka thënë: vendet e tjera kanë të njëjtën lirshmëri për përcaktimin e Kiblës mes jugut dhe veriut.” Po kështu Ibn cAbd al-Barr ka thënë: “Kjo është e saktë dhe nuk mund të mohohet, e për më tepër, në lidhje me të nuk ka asnjë mosmarrëveshje mes dijetarëve.” El-Athram ka thënë: “E

kam pyetur Ahmad Ibn Hanbelin rreth kuptimit të këtij hadithi dhe ai më është përgjigjur: “Kjo vlen për të gjitha vendet përveç Mekës tek Shtëpia dhe një devijim sado i lehtë prej saj do të thotë shmangie nga Kibla.” Pastaj ai tha: “Kjo është Lindja” dhe drejtoi gishtin në drejtim të saj dhe “ky është perëndimi” dhe tregoi në drejtim të tij dhe mes tyre është Kibla. Unë i thashë: “Lutja e atij që drejtohet diku mes tyre është e vlefshme. Ai tha: “Po dhe ai duhet të kërkojë mesin.” Ibn cAbd al-Barr komenton në pohimin e Ahmedit: “Kjo vlen për të gjitha vendet”, duke shpjeguar që e ka fjalën për të gjitha vendet që, ashtu si Medina, janë të drejtuara nga Jugu, ku ndodhet Qabja, e kështu ata qendrojnë të drejtim të saj dhe mund të shmangen nga e majta dhe nga e djathta mes lindjes dhe perëndimit në anë e tyre të djathtë dhe në Lindje në anën e tyre të majtë. Po kështu, banorët e Jemenit kanë të njëjtin fleksibilitet në Kiblën e tyre mes lindjes dhe perëndimit, kur ata kthehen në drejtim të Kiblës, ata kanë lindjen në anën e djathtë dhe perëndimin në anën e majtë. Po kështu, banorët e Irakut dhe Khurâsânit kanë të njëjtën lirshmëri për t’u vendosur përballë Kiblës mes jugut dhe veriut. Ndërsa banorët në anën e kundërt të Irakut kthehen nga ana e kundërt. Kibla është kufizuar vetëm për banorët e Xhamisë së Shenjtë. Ajo zgjerohet pak për banorët e Mekës dhe zgjerohet edhe pak më shumë për banorët e Haremit [rrethinat e Tokës së Shenjtë] dhe më pas është po aq e gjerë sa ç’është përshkruar më lart për banorët e vendeve të tjera “.

Për hir të saktësisë po përmendim rastin e dytë ku citohet ky hadith në Sunan al-Tirmidhî të Abdullâh Ibn Jacfar al-Makhramî :

“Al-Hasan Ibn Bakr al-Marwazî transmeton, al-Mucallâ Ibn Mansûr transmeton në autoritetin e Abdullâh Ibn Jacfar al-Makhramî, ky nga cUthmân Ibn Muhammad al-Akhnasî, ky nga Sacîd al-Maqbarî, ky nga Ebu Hurejra, që Profeti, paqja qoftë mbi të, ka thënë: “Mes Lindjes dhe Perëndimit ka një Kibël.” Abû cÎsâ ka thënë: “Ky hadith është hasen sahîh. Transmetuesi quhej cAbdullâh Ibn Jacfar al-Makhramî sepse është i biri i el-Miswar Ibn Makhramah. Shumë nga Shokët e Profetit, paqja qoftë mbi të, kanë transmetuar që mes Lindjes dhe Perëndimit ka një Kibël. Disa prej tyre ishin Umar Ibn el-Khattâb, cAlî Ibn Abî Tâlib, Ibn cAbbâs. Ibn cUmar ka thënë: “Nëse kërkon Kiblën, krahu i djathtë duhet të jetë nga perëndimin, ndërsa krahu i majtë duhet të jetë nga lindja dhe kudo mes këtyre gjendet Kibla. Ibn al-Mubârak ka thënë: “Kudo mes lindjes dhe perëndimit gjendet Kibla dhe kjo vlen për popujt e lindjes.” Dhe, për popullin e Marw-it [vend në Persi] ai zgjodhi drejtimin nga e majta”.

Le të bëjmë një përmbledhje të diskutimit të mësipërm. Sa u tha më sipër tregon që selefët e hershëm kanë pranuar pak fleksibilitet në përcaktimin e Kiblës dhe se ajo nuk është përcaktuar me saktësi kompas, sepse muslimanët e hershëm nuk kanë patur mjetet e duhura për një saktësi të tillë. Thënia profetike për gjetjen e Kiblës përdoret edhe sot. Sipas shkollave hanefije, malikije dhe hanbelije të Jurisprudencës islame, kriteret për kahun e qendrimit gjatë faljes (d.m.th. Kibla) kanë të bëjnë thjesht me kthimin e një pjese të fytyrës në drejtim të Qabes. Kjo nënkupton 180°, nga e majta në të djathtë, në mënyrë të tillë që, kur Qabja është mes këtyre dyjave, atëherë quhet se ndodhet në drejtimin e duhur për lutjen. Sipas shkollës shafije, drejtimi i lutjes është një kusht i nevojshëm. Nëse drejtimi nuk dihet, atëherë personi duhet të pyesë dikë që e di; nëse nuk gjen një person të tillë, atëherë duhet të përdorë gjykimin e vet.[20]

7. Përcaktimi i Kiblës në kohët e hershme [21]

Duke folur mbi “saksin” e fortë të drejtimin të muslimanëve të hershëm, Crone thotë:

“Megjithatë, ka shume pak te ngjare qe pushtuesit e fundit [d.m.th. muslimanet] me një ndjenjë të fortë të prejardhjes së tyre te kenë një nocion naiv të Kiblës që është popullor mes ulemave në Azinë

Qendrore dhe Spanjën në periudhën e Mesjetës”. [22]

Sensi i orientimit të njerëzve nuk është aq i fortë sa ai i zogjve shtegtarë. Mund të thuhet që, nëse njerëzit kanë udhëtuar, pjesa më e madhe e tyre kanë të paktën një ide të vakët të drejtimit nga i cili kanë udhëtuar, madje edhe në largësi të mëdha. Sigurisht kjo është veçanërisht e vërtetë në momentin e ardhjes së Islamit, kur mjetet për përcaktimin e saktë të drejtimit nuk ishin të disponueshme. Crone ngre linjën e vet të arsyetimit mbi baza shumë të dobëta, me anë të të cilit, ajo ose fsheh disa të dhëna, ose nuk mund ta mbështesë me të dhënat e duhura. Shkapërderdhja e fjalëve të tilla si “sens i fortë”, “për hir të saktësisë” etj. më tepër pasqyron një përpjekje të dëshpëruar për të arritur në një përfundim të projektuar paraprakisht, se sa një trajtim të një çështjeje në një mënyrë objektive dhe metodike. Më sipër kemi paraqitur një shembull të tillë.

Duke ndjekur verbërisht hapat e Crone, Smith, shprehet se arabët e hershëm ishin në një farë mënyrë mjeshtra të orientimit në horizont, për arsye se jetesa e tyre ishte e lidhur ngushtë me udhëtimet në shkretëtirë dhe se “sigurisht” ata dinin të “ndiqnin” yjet. Ai thotë:

“Disa muslimanë hedhin idenë se mbase muslimanët e hershëm nuk e kanë ditur drejtimin e Mekës. E megjithatë këta ishin tregtarë të shkretëtirës, që udhëtonin në karvane! Jetesa e tyre varej nga udhëtimi nëpër shkretëtirë, e cila ka pak pamje e pika referimi dhe nuk ka rrugë, për shkak të stuhive të rërës. Gjëja që ata dinin të bënin më mirë ishte ndjekja e yjeve. Jeta e tyre varet nga kjo njohuri. Dhe nuk ka dyshim që ata e dinin dallimin mes veriut dhe lindjes”.

Paragrafi i mësipërm nuk bën gjë tjetër veçse tregon paditurinë e Smith në lidhje me bazat e astronomisë për përcaktimin e Kiblës. Mënyra më e saktë në përcaktimin e Kiblës ishte me anë të gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike dhe jo me anë të yjeve..[23] Pozicioni i yjeve ndryshon në varësi të gjerësisë, gjatësisë dhe periudhës së natës (dhe ditës!). Në dallim nga pretendimet e Crone dhe Smith, David King, i cili ka kryer studime të veçanta në lidhje me përcaktimin e Kiblës në perudhat e hershme dhe të vonshme në Islam, thotë:

“Në dy shekujt e parë të Islamit, kur janë ndërtuar xhamitë nga Andaluzia deri në Azinë Qendrore, muslimanët nuk kishin mjete të vërteta shkencore për të gjetur Kiblën. Është e qartë që ata e dinin me përafërsi pikën drejt së cilës ishin nisur, kudo që të ishin dhe drejtimi i rrugës që përshkonin pelegrinët niseshin për në Mekë mund të ishte, në disa raste, në të vërtetë është përdorur si Kibël. Por, përveç kësaj, ata ndiqnin edhe dy procedura themelore, duke iu përmbajtur traditës dhe duke zhvilluar një metodë të thjeshtë”. [24]

Pra, në fillimet e Islamit, Kibla përcaktohej sipas traditës së Profetit, paqja e Zotit qoftë mbi të, me anë të mjeteve të thjeshta. Sipas traditës së Profetit, paqja e Zotit qoftë mbi të:

“Kibla ndodhet mes lindjes dhe perëndimit”.

Praktika dhe zakonet e Profetit, paqja e Zotit qoftë mbi të, janë imituar nga besimtarët.. Kur ai ishte në Medinë, falej nga jugu në drejtim të Mekës; dhe kishte prej atyre që garonin në ndjekjen e shembullit të tij, duke u falur në drejtim të jugut, kudo që të ndodheshin, qoftë në Andaluzi apo në Azinë Qendrore, një pikë e rëndësishme kjo, së cilës do t'i kthehemi më vonë. Të tjerët ndoqën shembullin e brezit të parë të muslimanëve, të cilët i kanë ndërtuar xhamitë e para në zona të ndryshme të botës islame, duke u bazuar në traditën profetike dhe dukuritë astronomike të horizontit.

Orientimi i xhamive që u konvertuan në të tilla nga ndërtesat e mëparshme fetare, konsiderohej i pranueshëm për Kiblën; i tillë ishte edhe rasti i ndërtimit të xhamive në Jeruzalem dhe Damask, ku

Kibla ishte përcaktuar të ishte në drejtim të jugut.

Si janë kthyer në xhami kishat e hershme?

“Në Homs, për shembull, ata morën një të katërtën e kishës së Sh. Gjonit. Si është kthyer një kishë në xhami? Mund të merret me mend lehtë. Në Siri, Kibla është në drejtim të jugut, ndërsa Kishat janë drejtuar nga perëndimi. Në këto rrethana që e mjaftueshme vetëm të mbyllej dera perëndimore, të hapej një hyrje e re në murin verior dhe lutja të bëhej përgjatë rrugicave mes karrikeve. Dhe vërtetësia e një veprimi të tillë mund të provohet në Xhaminë e Madhe në Hama, ku ana perëndimore e Kanisah al-cUzma (Kisha e Madhe) që u kthye në xhami në vitin 636-7 e.s, tani përbën skajin perëndimor të faltores. Tri dyert e saj perëndimore janë kthyer në dritare dhe hyrja tani është nga veriu”. [25]

Gjithashtu, Creswell flet mbi xhamitë në Persi, e veçanërisht atë në Istakhr dhe Qasvîn, të cilat janë konvertuar ndoshta nga apadâna, apo nga stili i pallateve të mbretërve persianë, më një çati të sheshtë që shtrihej mbi disa kolona. [26]

Shumë xhami të hershme u ndërtuan në drejtimin e përcaktuar nga dukuritë e horizontit astronomik, të tilla si lindja dhe perëndimi i diellit në ekuinokset apo solsticet dhe të yjeve apo grupe yjesh të ndryshëm, që ishin më të ndritshëm se të tjerët; i tillë është, për shembull, rasit i Egjiptit dhe Azisë Qendrore, ku xhamitë më të hershme ishin ndërtuar, përkatësisht në drejtim të lindjes dhe perëndimit të diellit dimëror. Drejtimi i njohur si Qibalat al-Sahâbah, “Kibla e Sahabëve”, mbeti shumë e njohur për shumë shekuj me radhë. Një shembull i tillë është xhamia e Amr bin al-cÂs in Fustât, në periferi të Kajros, që e kemi përmendur më lart, gjendet përballë lindjes së diellit perëndimor. [27]

Arsyeja e përdorimit të metodave astronomike për përcaktimin e Kiblës është se brezi i parë i muslimanëve, të cilët ishin shumë të mësuar me Qaben, e dinin që kur qendronin përballë ndërtesës, ata ishin përballë me një drejtim të veçantë astronomik. Në mënyrë që ta kryenin faljen nga ana e duhur e Qabes, që lidhej me vendndodhjen e tyre aktuale gjeografike, ata përdornin të njëjtin drejtim të Kiblës, të përcaktuar astronomikisht, siç do të bënin sikur të qendronin në këmbë drejtpërdrejt përballë atij segmenti të veçantë të Qabes. Ky nocion i Kiblës është, pa dyshim, krejt i ndryshëm nga ai që është përdorur nga astronomët. Metoda të tilla të thjeshta për gjetjen e Kiblës me anë të dukurive të horizontit astronomik përmenden edhe në tekstet ligjore dhe traktatet që kanë të bëjnë me astronominë popullore. Gjithashtu, nga burimet mesjetare gjejmë drejtime të Kiblës të shprehura me terminologjinë e drejtimeve të erës. Shumë skema të erërave të shprehura me anë të lindjeve të diellit apo të yjeve ishin pjesë e astronomisë dhe metereologjisë popullore të Arabisë pre-islamike [siç tregohet në figurën më poshtë]. Astronomia popullore lulëzoi krahas me astronominë matematike (nga shekulli III/ IX e këtej), por ka qenë e njohur dhe e praktikuar shumë më tepër se kjo e fundit.

Picture12

Image not found or type unknown

Figura 11: Drejtimi i bazës kënddrejtë të Qabes në drejtim lindjes së yllit Canopus dhe solsticit të verës, siç thuhet në burime të shumta mesjetare, më të hershmet e të cilave datojnë nga shekulli i VII. Janë paraqitur erërat “kardinale”, ku secila rreh drejt një muri të Qabes. Pika e ngritjes së yllit Canopus është e saktë brenda 2° . [28,29]

Siç mund të shihet, përcaktimi i Kiblës në xhamitë e konvertuara nga ndërtesat e mëparshme fetare apo xhamitë e hershme, ishte vetëm një hamendësim i thjeshtë dhe nënkuptonte ndjekjen e shembullit të Profetit, paqja e Zotit qoftë mbi të, Shokëve të tij apo brezit të parë të muslimanëve.

Picture13

Image not found or type unknown

Figure 12: Skemë e thjeshtë e gjeografisë së shenjtë në tesktin e botuar të Kitâb al-Masâlik të Ibn Khurradâdhbih (shek. III /IX). [30]

Prej shekullit III/IX e këtej, astronomët muslimanë që vepronin sipas traditës së astronomisë klasike, zhvilluan metoda për përcaktimin e Kiblës për çdo zonë duke u mbështetur në të dhënat gjeografike që zotëronin. Për ta, Kibla ishte drejtimi i rrethit më të madh që bashkangjitej me zonën e Mekës, të matur

si një kënd me meridianin lokal. Përcaktimi i Kiblës sipas këtij përkufizimi nuk është një problem i dorës së dytë për gjeografinë matematike, zgjidhja e të cilit ka të bëjë me përdorimin e formulave të ndërlikuara trigonometrike apo të konsideratave gjeometrike. Ata zotëronin gjithashtu edhe lista të vlerave të Kiblave për zona të ndryshme, si dhe tabela që tregonin Kiblën për çdo gradë të ndryshimit gjatësi-gjerësi në raport me Mekën.

Megjithatë, para fundit të shekullit II/VII dhe në fillim të shek. III/IX, muslimanët nuk i njihnin metodat matematikore dhe, edhe pas njohjes së këtyre metodave, ato nuk janë përdorur për përcaktimin e drejtimit të Kiblës. Një gjë të tillë e ilustron shumë mirë diagrami i mëposhtëm për Kiblat e qyteteve si Kordova, Kajro dhe Samarkanda.[31]

Picture14

Image not found or type unknown

Figure 13: Drejtime të ndryshme të Kiblës që janë përdorur në periudha të ndryshme në (1) Kordovë, (2) Kajro, dhe (3) Samarkand, sipas burimeve të ndryshme mesjetare.

Më poshtë paraqitet përshkrimi i Kiblave të ndryshme në qytetet e mëposhtëm

1. Kordova, Spanjë: Sipas një traktati të shekullit të XII (?) në lidhje me laboratorin astronomik, në Kordova janë ndjekur këto drejtime: (a) drejtimi i llogaritur me anë të formulës së përafërt standarde; (b) drejtimi i lindjes së diellit dimëror; (c) juglindje (kjo sipas interpretimit që i kam bërë tekstit të ngatërruar); (d) drejtimi i Xhamisë së Madhe ('pingul' me murin veriperëndimor të Qabes); dhe (e) në drejtim të jugut (që nuk përmendet konkretisht këtu).

2. Kajro, Egjipt: Sipas historianit egjiptian të shekullit të XV, al-Maqrizi, në Kajro respektoheshin këto drejtime: (a) në drejtim të lindjes (nuk përmendet asgjë konkrete); (b) drejtimi i lindjes së diellit dimëror (kjo është Kibla e Shokëve të Profetit; (c) drejtimi i llogaritur nga astronomi Ibn Yunus, me anë të një formule të saktë; (d) drejtimi i Xhamisë së Ibn Tulun (e shpjeguar në mënyra të ndryshme); dhe (e) cilido drejtim mes lindjes dhe perëndimit të yllit Canopus.

3. Samarkandë, Uzbekistan: Sipas studiuesit ligjor të shekullit XI, al-Bazdawi, në Samarkandë përdorëshin drejtimet e mëposhtme: (a) në drejtim të perëndimit (shkolla ligjore hanefije) (i korrespondon drejtimit ku ndodhej ndarja e rrugëve për ne Mekë dhe Samarkandë); (b) drejtimi i perëndimit të diellit dimëror (siç është përdorur në Xhaminë e Madhe); (c) në jugperëndim (i nënshtrohet një tabelle të paraqitur nga al-Bazdawi dhe është marrë nga burime të hershme); (d) drejtimi i llogaritur me anë të formulave matematike (që nuk përmendet konkretisht); dhe (e) në drejtim të jugut (shkolla ligjore shafije) (i korrespondon Kiblës së përdorur nga Profeti në Medinë).

Përfundim

Crone, Cook dhe Smith kanë hedhur idenë që xhamitë e hershme janë ndërtuar në drejtim të një faltoreje të paemër në veri të Arabisë, apo në afërsi të Jeruzalemit. Megjithatë, një analizë më e hollësishme me mjeteve moderne tregon që Kiblat e xhamive të hershme janë përcaktuar me metoda astronomike; lindja e diellit dimëror për xhaminë në Egjipt dhe perëndimi i diellit dimëror për xhamitë në Irak. Si përfundim, është treguar që xhamitë e hershme nuk janë të orientuara në drejtim të Arabisë veriore dhe as në drejtim të Jeruzalemit. Në mbështetje të përfundimit tonë kemi shtuar gjithashtu studimin e 12 xhamive të hershme në rrafshnaltën e Negev-it.

Në shekujt e parë të Islamit, muslimanët nuk kanë patur mjete për të përcaktuar me saktësi Kiblën. Vetëm nga shekulli i tretë e më pas filluan të zbuloheshin dhe hynin në përdorim zgjidhje matematike për përcaktimin e Kiblës; madje edhe atëherë përdorimi i tyre nuk ishte shumë i zakonshëm. Astronomia popullore ka mbizotëruar dhe kjo shihet në xhamitë e ndryshme në Kajro, Kordova dhe Samarkandë. Kjo çoi në orientimin e gabuar të xhamive, duke bërë që në shumë raste ato të ishin të shmangura nga Kibla e vërtetë.

Dhe Allahu e di më mirë!

Shtojcë:

Llogaritja e azimuthit të lindjes dhe perëndimit të diellit

[Screen Shot 2019-08-26 at 2.45.31 AM](#)

Image not found or type unknown

a. Kjo llogaritje nuk parashikon lindjen dhe perëndimin e diellit në vendet gjeografike me ditë apo natë të përhershme, domethënë në pole.

b. Origjina e azimuthit është Veriu. Nje vlerë prej 242° tregon 242° në verilindje (apo 62° në jugperëndim).

c. Për vendet në perëndim të Greenwich-it (d.m.th., gjatësia negative gjeografike), për shembull $-10^\circ 10' 10''$, vendos një kutitë të gjithë ndryshorët $-10^\circ - 10' - 10''$. E njëjta gjë vlen edhe për gjerësinë.

Përkufizimi i termave astronomikë

Azimuth: Largësia horizontale këndore nga një pikë reference në një pozicion, apo objekt referimi, si një rreth i madh që ndërlidh një trup qiellor, zakonisht të matur me gradë nga ana e lëvizjes së akrepave të orës përgjatë horizontit nga një pikë në drejtim të veriut.

Equinoksi i pranverës: Është njëra nga dy pikat ku Eklipsi përshkon Ekuatorin Qiellor. Në ekuinoksin e pranverës, dielli lëviz përmes ekuatorit nga Hemisfera Qiellore Jugore në Hemisferën Qiellore Veriore. Mbërritja e diellit në ekuinoksin e pranverës me ose rreth atës 21 mars shënon fillimin e pranverës.

Equinoksi i vjeshtës: Është njëra nga dy pikat ku eklipsi përshkon Ekuatorin qiellor. Në Ekuinoksin e vjeshtës dielli lëviz nëpër ekuator nga hemisfera qiellore veriore në hemisferën qiellore jugore. Mbërritja e diellit në Ekuinoksin e vjeshtës më 23 shtator shënon fillimin e vjeshtës.

Solstici i verës: Është koha kur dielli arrin pikën e tij më veriore. Shënon fillimin e verës në hemisferën veriore dhe të kundërtën në hemisferën jugore. Kjo ndodh më 21 qershor.

Solstici i dimrit: Është koha kur dielli arrin pikën e tij më jugore. Shënon fillimin e dimrit në hemisferën veriore dhe të kundërtën në hemisferën jugore. Kjo ndodh më 21 dhjetor.

Referenca dhe shënime

[1] P. Crone & M. Cook, Hagarism: The Making Of The Islamic World, 1977, Cambridge University Press, fq. 23-24.

[2] Gjerësia dhe gjatësia e Wâsit dhe Kufa janë marrë nga Heavens-Above.

[3] P. Crone, Meccan Trade And The Rise Of Islam, 1987, Basil Blackwell: Oxford, fq. 198. Shih futnotwn 131.

[4] P. Crone & M. Cook, Hagarism, Op Cit., fq. 23-24.

[5] P. Crone, "The First Century Concept Of Hagra", Arabica, 1994, Vol. XLI, fq. 386-387.

[6] Abî al-Abbâs Ahmad b. Yahyâ b. Jâbir al-Balâdhurî (ed. M. J. De Goeje), Futuh al-Buldân, 1866, E. J. Brill: Leyden, p. 276. Al-Balâdhurî nuk përmend ndonjë kënd devijimi të kësaj xhamie. Nuk është çudi që, Crone dhe Cook, duke cituar al-Balâdhurî-n thonë që "kjo nënkuptohet nga tradita mbi xhaminë e parë në Kûfa....), shih Hagarism, Op Cit., fq. 173, futnota 27. Germat e pjerrëta janë tonat. Kemi llogaritur Kiblën nga plani i xhamisë që paraqitet në Encyclopaedia Of Islam, "Architecture",

1960, Volume 1, E. J. Brill: Leiden, fq. 611.

[7] D. A. King, "Science In The Service Of Religion: The Case Of Islam", Astronomy In The Service Of Islam, 1993, Variorum: Hampshire (Great Britain), p. 260. Shih figurën 12.

[8] D. A. King, "The Sacred Direction In Islam: A Study Of Interaction Of Religion & Science In The Middle Ages", Interdisciplinary Science Reviews, 1985, Vol. 10, p. 319.

[9] Për të dhëna më të hollësishme rreth kësaj teme shih "Astronomical Alignments In The Medieval Islamic Architecture" të D. A. King, Annals Of The New York Academy Of Sciences, 1982, Vol. 385, pp. 303-312.

[10] G. S. Hawkins dhe D. A. King, "On The Orientation Of The Kacbah", Journal For The History Of Astronomy, 1982, Vol. 13, fq. 103-105. Hoyland thotë që ideja e Hawkins dhe King është "intuitive dhe hedh dritë mbi periudhën mesjetare" por nuk është dakord kur idetë "retrojektohen në dy shekujt e parë të Islamit." Ai e konsideron "hamëndësim" vendndodhjen e xhamive të para, të tilla si xhamia e Amr bin al-cÂs në Fustât, përballë lindjes së diellit perëndimor; shih Seeing Islam As Others Saw It: A Survey And Evaluation Of Christian, Jewish And Zoroastrian Writing On Early Islam, të R. G. Hoyland, 1997, The Darwin Press, Inc.: Princeton (New Jersey), fq. 573. Me anë të llogaritjeve matematikore, ne kemi treguar qartë që orientimi i xhamive të hershme në Egjipt dhe Irak mbështetej vërtet në dukuri astronomike. Megjithatë, Hoyland kritikon ashpër hipotezën e Crone dhe Cook në lidhje me Kiblën e xhamive të hershme.

[11] G. S. Hawkins & D. A. King, "On The Orientation Of The Kacbah", Op Cit., p. 107 për orientimin e Qabes. Azimuthet e lindjeve dhe perëndimeve të diellit llogariteshin me anë të formulës së paraqitur në shtojcë. Aizmuthi për yllin Canopus është gjetur me anë të programit Starry Night Backyard 3.1 .

[12] S. Bashear, "Qibla Musharriqa And Early Muslim Prayer In Churches", 1991, The Muslim World, Volume LXXXI, Nos. 3-4., fq. 268.

[13] P. Crone & M. Cook, Hagarism, Op Cit., fq. 173, shih futnotën 29.

[14] M. Sharon, "The Birth of Islam In The Holy Land", in M. Sharon (Ed.) The Holy Land In History And Thought: Papers Submitted To The International Conference On The Relations Between The Holy Land And The World Outside It, Johannesburg 1986, 1988, E. J. Brill: Leiden, fq. 230.

[15] D. A. King, "The Sacred Direction In Islam: A Study Of Interaction Of Religion & Science In The Middle Ages", Op Cit., fq. 320.

[16] P. Crone & M. Cook, Hagarism, Op Cit., p. 173. See footnote 30. Also see W. Wright, Catalogue Of Syriac Manuscripts In The British Museum Acquired Since The Year 1838, Part II, 1871, British Museum: London, fq. 604.

[17] G. Avni, "Early Mosques In The Negev Highlands: New Archaeological Evidence On Islamic Penetration Of Southern Palestine", 1994, Bulletin Of The American Schools Of Oriental Research, Vëllimi 294, fq. 83-100.

[18] Po aty., shih fq. 95 për tabelat e tipit të xhamisë dhe orientimit të saj në vende të ndryshme në rrafshnaltën e Negev.

[19] Për shkak të afërsisë së këtyre vendeve, shmagja e Kiblës nga pika e referimit Sede Boqer nuk i kalon më shumë se $\pm 3^\circ$.

[20] Nuh Ha Mim Keller, The Reliance Of The Traveller: A Classic Manual Of Islamic Sacred Law, 1994, Amana Publications: Beltsville (Maryland, USA), pp. 123-125.

[21] Disa pjesë të diskutimit në këtë artikull janë marrë nga ref. 7, fq. 245-262.

[22] Shih ref. 3.

[23] Ky është një fakt shumë i njohur. Astronomët e hershëm muslimanë e kanë përdorur atë, programet e llogaritjes së Kiblës, si dhe orë që funksionojnë sipas këtyre parimeve. Për hollësi të mëtejshme mbi astronominë islame shih "Universal Solutions In Islamic Astronomy" të D. A. King, From Ancients Omens To Statistical Mechanics: Essays On The Exact Sciences Presented To Asger

Aaboe, eds. J. L. Berggren & B. R. Goldstein, 1987, Copenhagen University Library: Copenhagen, fq. 121-132. Shih gjithashtu: "Universal Solutions To Problems Of Spherical Astronomy From Mamluk Egypt & Syria" tw D. A. King, A Way Prepared: Essays On Islamic Culture In Honor Of Richard Bayly Winder, eds. F. Kazemi & R. D. McChesney, 1988, New York University Press: New York, fq. 153-184. Për metodat e hershme matematike për përcaktimin e Kiblës shih "The Earliest Islamic Mathematical Methods & Tables For Finding The Direction Of Mecca" tw D. A. King, Zeitschrift für Geschichte Der Arabisch-Islamischen Wissenschaften, 1986, Volume 3, Institut für Geschichte Der Arabisch-Islamischen Wissenschaften: Frankfurt, fq. 82-149. Për orët p.sh. katalogun e orëve Casio për përcaktimin e drejtimit të Kiblës

[24] David A. King, "Science In The Service Of Religion: The Case Of Islam", Op Cit., fq. 253.

[25] K. A. C. Creswell, A Short Account Of Early Muslim Architecture, 1968, Librairie Du Liban, Beirut, fq. 7.

[26] Po aty., fq. 7-8.

[27] David A. King, "Science In The Service Of Religion: The Case Of Islam", Op Cit., p. 260.

[28] Po aty., fq. 254.

[29] D. A. King, "The Sacred Direction In Islam: A Study Of Interaction Of Religion & Science In The Middle Ages", Op Cit., fq. 327.

[30] C. E. Bosworth, E. Van Donzel, B. Lewis & Ch. Pellat (eds.), Encyclopaedia Of Islam, "Makka", Vllimi VI, E. J. Brill: Leiden, fq. 183.

[31] D. A. King, "The Sacred Direction In Islam: A Study Of Interaction Of Religion & Science In The Middle Ages", Op Cit., fq. 325.

Date Created

26/08/2019

Author

erasmusi